

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Cristal Tours” sh.p.k

## Kreu I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

a. Sot në Vlore në datën 20 Nentor 2023 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “ Cristal Tours ” shpk, me vullnetin e lirë të ortakut te vetem, në bazë të ligit 9901 datë 14.04.2008”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Cristal Tours ” shpk, formohet nga ortaku themelues:

1. Gjerjgi Metushaj ,shtetas shqipetar,, i biri I Astritit dhe i Diellas, I datëlindjes 19/03/1986 lindur në Vlore e banues ne Vlore , lagjia “ 28Nentori” Rruga “ Mulla Xhaferi” , banese private Zk 9402 nr. 206 Vlore, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr.pasaporte I60319093V me afat skadence deri 27.02.2030.

b. I cili me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushton veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare " Cristal Tours " Shpk., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

## FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

### Neni 2

1. Shoqëria tregtare, është e organizuar si *Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar*.

2. Emërtimi i Shoqërisë është: " Cristal Tours " Shpk.

3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

### NENI 3

1. Shoqëria tregtare " Cristal Tours " Shpk, ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Vlores, lagjia “ 28Nentori” Rruga “ Mulla Xhaferi” , banese private Zk 9402 nr. 206 Vlore, tel.cel.0688668888 dhe email: gjergjimetushajo@gmail.com.

2. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.

5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## KOHËZGJATJA

### Neni 4

1. Shoqëria Tregtare "Cristal Tours ." Shpk., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.  
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË

## Neni 5

Objekti I veprimetarese se shoqerise "Cristal Tours " Shpk do të jetë:  
Agjensi turistike, operator turistik, operatur turistik detar, Guida Vip, Private dhe Grupe, Plazhet e Karaburunit, Ishulli i Sazanit, Shpella e Haxhi Alise, Grames etj, dhenie me qera automjete dhe skafe, lojra argetuese detare, transport turistesh per vete dhe per te trete.  
Për të arritur objektin e saj, shoqëria mund të përdor e përfitoj nga lehtësitet e parashikuara nga ligjet në fuqi edhe ato të ardhme, kombëtare, rjonale dhe komunitare.

## TE DREJTAT E SHOQËRISË

### Neni 6

Shoqeria tregtare "Cristal Tours " Shpk, nuk per gjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne në menyre të pavarur prej saj.  
Shoqeria mund të ndryshoje emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarise, administratorin, sipas vendimeve qe do të marrin ortakët.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100 000 lekë (njeqind mijë lek), i cili është tërësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 100 000 lekë (njeqind mijë lek).

1. **Gjergji Metushaj**, zotëruar i 1 (një) kuote apo 100 % të kapitalit të shoqërisë = 100 000 (njeqindmije lek)  
Ortaku kanë të drejtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.  
Kapitali fillestar nuk është paguar.

## NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

## NENI 9

- Perberja e kapitalit të shoqerise, fondet e krijuarit të saj si dhe perdonimi e rregullimi i çdo fondu të veçante përcaktuohen nga Ortaket sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
- Të ardhurat e përgjitheshme të shoqerise dhe në përgjithesi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve perkatese të rrjedhura prej tij.

## NENI 10

- Shoqeria Tregtare " Cristal Tours " Shpk, eshte pronare e pasurise së saj të cilën e perdor dhe e disponon në emer të saj në perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise së shoqerise.
- Shoqeria eshte e lire të bleje dhe të shfrytezoje të drejtë të tjera materiale në perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

- Të gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhën nga fondet e shoqerise.

## NENI 11

- Pasurite e shoqerise vleresohen në monedhe shqiptare.
- Aktiviteti financiar i shoqerise do të mbyllt me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
- Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortaket dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakeve të saj.

- NENI 12  
Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

## NENI 13

Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfittues do të behet pasi ata të pranojnë permbytjen e statutit të kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund të kete pesuar deri në momentin qe keto pjese të kapitalit themeltar behen të transferueshme.

## NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete qe nuk bejne pjese në shoqeri vetem me miratimin e Ortakut.

#### NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve në para dhe në natyre apo / zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakeve të shoqerise mbi bazen e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

### KREU I DYTË

#### ORTAKËRIA

##### NENI 16

Ortakët e shoqërisë tregtare " Cristal Tours " Shpk, gjëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqerise.

*Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve*

##### NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

### KREU I TRETË

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

##### NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **Neritan Caushaj**, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhënet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

### ASAMBLEJA

##### NENI 19

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë. Shprehimisht per te regjistruar shoqerine ne QKB, prokura behet para noterit nga ana e ortakut te saj.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

##### NENI 20

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likujdimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.



## **TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT**

### **NENI 21**

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqerinë në marrëdhënet e saj me të tretët, e në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrijedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asambllene e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

### **NENI 22**

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### **NENI 23**

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, têrheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **NENI 24**

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkeshën e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

## **FORCAT MADHORE**

### **NENI 25**

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftesi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rr Ethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmanget me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësojnë detyrimet e tij për arsyet e forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

## **SHPËRNDARJA E SHOQËRISË**

### **NENI 26**

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkaku. Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve.

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negativ(Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyet e tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose më shume likujdatorë duke ju përcaktuar detyrat. Në rastin e likujdimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimii "Shoqëri në likujdim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **BAZA LIGJORE**

Neni 27

Faqja 4 nga 5

Xhaferaj Kontabilitet

E gjithë veprimitaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", I ndryshuar si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 28

### RUAJTJA E SEKRETIT

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimitarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen secrete.

NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", I ndryshuar si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë.

NENI 31

Ky Statut përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

### ORTAKU I VETEM

Gjergji Metushaj

Gjergji Metushaj /